L I G J
Nr.7918, datë 13.4.1995

PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1030, DATË 23.2.1995 "PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKË PRIVATIZIMI)" DHE DEKRETIT NR.1049, DATË 27.3.1995 "PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR.103O, DATË 23.2.1995 "PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohen me ndryshime dekretet nr.1030, datë 23 .2.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)" dhe nr.1049, datë 27.3.1995 "Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995 "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit" me përmbajtjen e plotë të tyre si më poshtë:

Neni 2

Për privatizimin e pasurisë shtetërore nëpërmjet letrave me vlerë Këshilli i Ministrave emeton "Bono privatizimi".

Neni 3

Bono privatizimi do të përfitojnë të gjithë shtetasit, të cilët në datën 1.1.1995 kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe janë regjistruar në zyrat e gjendjes civile, me përjashtim të kategorive të parashikuara në nenin 6 të këtij dekreti.

Bonot e privatizimit do të jenë të vlefshme deri në datën 31.12.1999 dhe do të përdoren sipas afateve që do të jenë të shtypura në bono dhe sipas afateve që do të përcaktojë Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Bonot e privatizimit do të jenë të formës jo emërore. Vlera e tyre do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me vlerën e pasurisë së ndërmarrjeve shtetërore që do të privatizohen sipas këtyre raporteve:

- shtetasit e moshës nga 18 vjeç deri në 35 vjeç koefiçienti 1
- shtetasit e moshës mbi 35 vjeç deri në 55 vjeç koefiçienti 1.5
- shtetasit e moshës mbi 55 vjeç e lart koefiçienti 2

Neni 5

Bonot e porivatizimit mund të përdoren nga zotëruesi i tyre për qëllimet që vijojnë:

- për të hyrë si aksionerë në shoqëritë tregtare që do të krijohen nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore,
- për të blerë elemente të veçanta të pasurisë së ndërmarrjeve shtetërore që do të privatizohen,
- për të hyrë si aksionerë në shoqëritë investuese të letrave me vlerë.

Bonot e privatizimit mund gjithashtu të tregtohen midis shtetasve.

Neni 6

Nuk përfitojnë bono privatizimi kategoritë e shtetasve si më poshtë:

l. Personat që deri në datën e emetimit të bonove të privatizimit kanë përfituar falas pasuri nga procesi i privatizimit të pronës shtetërore sipas ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” dhe sipas dispozitave të tjera ligjore për privatizimin, me përjashtim të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

2. Personat dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët kanë përfituar tokë në pronësi sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, pavarësisht se ku e kanë vendbanimin e tyre në kohën e hyrjes në fuqi të këtij dekreti.

3. Personat dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët deri në datën e emetimit të bonove të privatizimit kanë përfituar tokë në përdorim e pasuri tjetër nga aktet ligjore në fuqi për privatizimin e ndërmarrjeve bujqësore në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”.

Pikat 2 dhe 3 të këtij neni nuk do të zbatohen për personat me banim në fshat, të cilët nuk kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet bujqësore, por që kanë patur vjetërsi pune në marrëdhënie me shtetin të paktën prej 12 vjet e 6 muaj”.

Neni 7

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat e emetimit dhe të shpërndarjes së bonove, rregullat e përdorimit në procesin e privatizimit, si dhe rregullat e tjera të nevojshme në zbatim të këtij dekreti.

Neni 8

Personat që nëpërmjet falsifikimeve, mashtrimeve ose në çdo formë tjetër të paligjshme përfitojnë pa të drejtë bono privatizimi, dënohen me gjobë në masën 5 herë më shumë se vlera e përfituar.

Me vendosjen dhe arkëtimin e gjobave ngarkohen seksionet e financës në organet e pushtetit lokal.

Neni 9

Personat e ngarkuar për regjistrimin e qytetarëve që përfitojnë bono privatizimi ose që lëshojnë dokumente për këtë qëllim, kur me veprimet e tyre çojnë në përfitime të padrejta të bonove të privatizimit nga qytetarët, dënohen sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

Neni 10

Ngarkohet Banka e Shqipërisë të shtypë bonot e privatizimit sipas karakteristikave të përcaktuara nga Ministria e Financave.

Neni 11

Ministria e Financave ngarkohet me përgatitjen e dispozitave ligjore për organizimin dhe veprimtarinë e shoqërive investuese të letrave me vlerë dhe për veprimtarinë e bursës (tregut të letrave me vlerë).

Neni 12

Ngarkohet Banka e Kursimeve për regjistrimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit.

Neni 13

Në procesin e privatizimit të pronës shtetërore, lekët e privatizimit, të përfituara nga ish të përndjekurit politikë, si dhe obligacionet që do t'u shpërndahen ish-pronarëve, për kompensimin e pasurisë së tyre, do të kenë të njëjtin trajtim si edhe bonot e privatizimit.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1076, datë 26.4.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha